



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

<http://kk.rks-gov.net/istog/>



Komuna e Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Tel: 038/200 438 14

DRAFT-RREGULLORE PËR TREGUN TËRËDITOR NË ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga dëgjimi publik për Draft-Rregulloren për Tregun Tërëditor në Istogmbajtur më: 15.05.2025, në Sallën e Kuvendit Komunal, filluar me punë në ora 10:00.

Në Dëgjim ishin të pranishëm:

1. Ilir Ferati, Kryetar;
2. Drejtor të drejtorive Komunale;
3. Ardon Arifaj, Zyra e Kryetarit
4. Liliana Frrokaj, Zyra e Kryetarit;
5. Alketa Bujupaj, Zyra e Kryetarit

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i komunës, z. Ilir Ferati dhe Drejtoret e Drejtorive

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Drejtori për Ekonomi dhe Zhvillim, Genc Ademaj

Drejtori, z. Genc Ademaj - përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje dhe hapi dëgjimin publik për Draft-Rregulloren për Subvencione në Komunën e Istogut dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

R E N D D I T E

1. Njoftimi për Draft-Rregulloren për Tregun Tërëditor në Istog,
2. Pyetje dhe Përgjigje

PROCESVERBAL

Takimi u organizua nga Komuna e Istogut me qëllim të diskutimit të Draft-Rregullores për funksionimin e tregut tërëditor. Në takim morën pjesë përfaqësues institucionalë, tregtarë lokalë dhe qytetarë të interesuar.

Takimi u hap nga Drejtori i drejtorisë për zhvillim ekonomik, i cili prezantoi qëllimin e rregullores dhe rëndësinë e saj për rregullimin e veprimtarisë tregtare në hapësirat publike. U theksua se rregullorja synon krijimin e kushteve më të mira për tregtarët dhe konsumatorët.

Gjatë prezantimit u shpjeguan dispozitat që lidhen me orarin e punës, kushtet higjienike, rendin dhe sigurinë në treg, si dhe obligimet e tregtarëve. U theksua se zbatimi i rregullores do të ndikojë në përmirësimin e imazhit të tregut dhe rritjen e besimit të qytetarëve.

Tregtarët shprehën shqetësime lidhur me tarifat, hapësirat në dispozicion dhe nevojën për përmirësim të infrastrukturës. Përfaqësuesit komunalë dhanë sqarime dhe u zotuan se kërkesat e arsyeshme do të shqyrtohen në fazën përfundimtare.

Në përfundim, u konstatua se rregullorja është e nevojshme dhe se bashkëpunimi ndërmjet komunës dhe tregtarëve është kyç për funksionimin e suksesshëm të tregut tërëditor.

Procesmbajtës:
Ardon Arifaj, Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave

